



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 29.05.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **25.05.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Pro Medical SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së” me numër prokurimi 206-23-4215-1-1-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Pranohet** kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik Pro Medical SH.P.K. e dt.25.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së” me numër prokurimi 206-23-4215-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 16.04.2023, të publikuar në platformën elektronike;
2. Janë dhënë sqarimet shtesë, dokumenti i publikuar me datë: 26.05.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, pas sqarimeve të datës 26.05.2023 vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Pro Medical SH.P.K. me datë 25.05.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së” me numër prokurimi 206-23-4215-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, sot me datë 29.05.2023, e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE Pro Medical SH.P.K.:

Aktivitet të prokurimit është në kundërshtim me Ligjit të Prokurimit Publik, nr.04/L-042 pra dispozitat e shkelura te LPP-se:

Neni 1- Qëllimi

Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi

Neni 28 Specifikimet teknike

Pretendimet ankimore:

Me daten 16.05.2023 ne kemi dorzuar kerkesen per informacion shtese konfrom LPP Neni 53 por AK Akoma nuk ka kethyer pergjigjej kurse data e dorzimit eshte 29.05.2023 kurse ne me daten 22.05.2023 jemi informuar nag AK se do te shtyhet afati por Akoma nuk ka ndryshim ne DT (Shiko Kerkesen per sqarime dhe email).

Përshkrim	Kodi i procesit	Emri i procedurës	Stadi i procedurës	Data e dërgimit të
AMBIËNË KËRKESË PËR INFORMACIONE SHITESHE MBI	206-23-4216-1-1-1	Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore dhe pajisje të QKUR-së	Qëllimi / Objektivi	16.05.2023 14:43

RE: Kerkese per sqarime per AK me titull "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore dhe pajisje të QKUR-së"

Berat Marmullaku <Berat.Marmullaku@rks-gov.net>
To: Pro Medical
Mon 5/22/2023 8:53 AM

You replied to this message on 5/25/2023 8:53 AM.

Te nderuar,

Kërkesa juaj është duke u shqyrtuar, do ti kenë sqarimet shtese dhe do te shtyhet afati për ofertim.

Me respekt,

Berat Marmullaku

Neni 1- Qëllimi -Ne nuk pajtohemi me specifikacion teknike dhe kriter ne DT te cekur nga Autoritetit Kontraktues ngase i njëjti është në kundërshti me nenin 1 te Ligjit për Prokurim Publik dhe paragrafin nuk ka marrë ne konsiderate detyrimin.

AK në këtë rastin tonë ka shkelur Nenin 1 paragrafin 2 të LPP citim "Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji"

Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi- Ky nene është parimi bazë i Prokurimit Publik, ku cekë se Autoriteti kontraktues duhet ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu, autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të

prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

Ne DT ju si AK keni vendosur tek Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 4. Kërkohe certifikata ISO 9001 dhe ISO 13485 e prodhuesit.

Pra ju keni kerkuar qe ISO 9001 dhe ISO 13485 por kjo eshte nje kerkese e pa mundur te plotesohet nga OE sepse me ISO 13485 certifikohen vetem prodhuesi e paisjeve mjeksore, kurse ISO 9001 mund te kerkohet per OE sepse nuk jane obliguar te gjitha prodhuesi te kene edhe ISO 9001 deri sa e kane ISO 13485 sepse jo po thuaj parazvleshme.

Ne kerkojm qe ISO 9001 te largohet apo te kerkohet per OE, kurse ISO 13485 te kerkohet vetem per prodhuesin ose vetem njera per tyre te dorzohet per prodhuesin sepse jane te barazvleshme.

Kërkesa 5. Kërkohe certifikata CE e produkteve. Ju duhet te keni parasysh se disa paisjet jane Class I dhe ne baze 93/42/EEC e amandamentuar me direktivën 2007/47/EC disa paisjet jane Class I dhe ne rast konkret kerkohet vetem DoC pra Deklaratës së Përputhshmërisë, e jo CE.

Ne kerkojm qe per pasjet qe nuk kerkojet CE te pranohet pra DoC sepse kjo eshte e barasvleshme me CE per paisjet qe jane Class I , sepse edhe AKPPM ne rastet e tilla per Class I kerkohen vetem DoC per leje importi.

Neni 28 Specifikimet teknike-Nenin 28 te LPP-se Përpilimi i specifikimeve teknike te detyrueshme nga njesia e kerkeses per keto paisje bie ndesh me Nenin 28

Paragrafi 2 te LPP-se "Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik".

Gjithashtu ky përpilim teknike nga njesia e kerkeses është diskriminues për te gjitha prodhues tjerë sepse nuk kane mundësi konkurrinimi ne raport me kushte teknike te konkurrences/trajtim i barabarte per shkak pozicionit numer 8, andaj kjo bie ndesh me RrUOPP, Neni 20 Paragrafi 3" *Specifikimet teknike do të përshkruajnë dhe përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës, siç janë cilësia, performanca, kërkesat e dizajnit, dimensionet, siguria, sigurimi i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimi, shënimi dhe etiketimit" dhe paragrafi 4 te ketij Neni "Specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.*

Ja deshmite dhe krahasimi per LOT 14. Karhasimi jane vetem copy/past shiko me poshte ose proven si deshmi.

ACCUREF K-900/R-800 Specifications

Product page



		K-900	R-800	
Refractive Measurement Range (Ref Measurement)	Sphere (S)	Measurement Range	-30D ~ +22D (VD=12) -22D ~ +30D (VD=8)	
		Step	0.12D, 0.25D (Switching)	
	Cylinder (C)	Measurement Range	-10D ~ +10D (VD=12)	
		Step	0.12D, 0.25D (Switching)	
	Axis (A)	Measurement Range	0° ~ 180°	
		Step	1°/5°	
	Vertex Distance		0, 10, 12, 13.5, 15 mm	
	Minimum Pupill Distance Measurement		0.1 mm	
	Corneal Curvature Radius Measurement	Corneal Curvature Radius	Measurement Range	0.1 mm ~ 8.5 mm
			Step	0.1 mm
Corneal Refractivity		Measurement Range	33.75D ~ 47.5D (whole corneal refractive index n=1.3775)	
		Step	0.12D, 0.25D (Switching)	
Degree Of Corneal Astigmatism		Measurement Range	0D ~ 180°	
		Step	0.12D, 0.25D (Switching)	
Axis Angle		Measurement Range	0° ~ 180°	
		Step	1°/5°	
PD Measurement		Measurement Range	50mm ~ 85mm	
		Step	1mm	
Pupill Diameter Measurement	Measurement Range	0.0 mm ~ 0.8 mm		
	Step	0.1 mm		

LOTI 14
AUTO-KERATO-REFRAKTOMETËR - UPS, TAVOLINË E MOTORIZUAR,
KARRIGE PËR KONTROLLUESIN DHE PACIENTIN - 5 copë,
Sasia - 5 copë

1. Diapazoni i matjes sferike (S): -30D deri në +22D në VD: 12 mm, -22D deri në + 30D në VD: 0 mm
2. Njësia e ekranit sferike: 0.12D, 0.25D
3. Diapazoni i matjes cilindrike (C): -10D deri + 10D
4. Simboli i matjes: mm, minusD (-D), plusD (+D)
5. Njësia e ekranit cilindrike: 0.12D, 0.25D
6. Diapazoni i matjes së astigmatizmit: 0° deri 180°
7. Simboli i ndërrimit: minus, plus dhe plus/minus
8. Njësia e ekranit të boshtit të astigmatizmit: 1°
9. Distanca nga maja: 0 mm, 10 mm, 12 mm, 13.5 mm, 15 mm ose më e madhe
10. Diapazoni i matjes në distancës së bebëzës (PD): 10 mm deri 85 mm
11. Njësia matëse e distancës së bebëzës (PD): 1 mm
12. Diapazoni i matjes së diametrit të bebëzës: min. 2 mm deri në maksimum. 8.5 mm
13. Njësia matëse e diametrit të bebëzës: 0,1 mm
14. Diapazoni i matjes së rrezes së lakores së kornesë: 5 mm deri 10 mm
15. Njësia matëse e rrezes së lakores së kornesë: 0.01 mm

Qaq

Mir



Qaqy Instrument
Reexam Co., Ltd.
Kagawa factory
 958 Iseuchi, Komori-cho,
 Takamatsu-shi, Kagawa-ken,

3-3-3 Iseuchicho Komori, Chiyoda-ku, Tokyo,
 101-0048 Japan
 TEL:+81-3-5242-9471 FAX:+81-3-5242-9472
 E-mail:qaq@reexam.co.jp
 Website:https://www.reexam.co.jp

Pra edhe LOTO si **LOTI 10, 12, 14, 15, 16 dhe LOT 18**

Ne kemi vrejtur se specifikacionet per keto LOTO ne vecanti po thuaj per te gjitha LOT jane vetem copy/past ku ne nje menyre jane ne kundershtime me LPP Neni 7 dhe Neni 28 sepse eshte favorzuar vetem nje prodhuesi i caktuar, dhe pyetja jone eshte si me poshte.

Pyetja qe kemi derguar epr sqarime me daten 16.05.2023 per AK dhe NJK ishte:

Ne kerkojm nga AK dhe NJK qe te mundeson OE te ofertojm me pasijet me secfikacione te peraferta por qe plotesojn qellimin e keti aktiviteti te prokurimit sepse siq jane tani jane vetem copy/past specifikacionet teknike, ku edhe kemi bere kralisimi ne mes DT dhe prodhuesit jane vetem copy/past, pra qe te mos favorzohet prodhuesi e caktuar ne kerkojm qe te mundesoj OE te ofertoj me pasijet me peraferta.

Te largoj nga DT certifikata ISO 9001 (ose kjo te kerkohet per OE) ose ISO 13485 apo ISO 9001 te drozohet per prodhuesi pra njera prej tyre.

VENDIMI

I. APROVOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim dhe

II. Te largoj nga DT certifikata ISO 9001 (ose kjo te kerkohet per OE) ose ISO 13485 apo ISO 9001 te drozohet per prodhuesi pra njera prej tyre.

III. Te korrixhoj specifikacionet teknike apo te mundesoj që OE te oferoj me pasijet tjera peraferta me performance me mire apo te peraferta.

Dëmet materiale

Shpenzimet për ankesa dhe humbje financiare te planifikuara

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore te OE

- Sa i përket pretendimit për trajtimin e sqarimeve shtesë, AK-MSh sapo ka pranuar pyetjet sqaruese te OE, menjëherë i kemi adresuar për përgjigje nga SHSKUK si njësie e kërkesës, por na janë vonuar derisa na janë përgjigjur, andaj me datën 26.05.2023 i kemi pranuar përgjigjet nga njësia e kërkesës dhe menjëherë po atë dite është proceduar me sqarimet shtese dhe me formularin e korrigjimeve **B54** **Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara.**

- Sa i përket pretendimit për certifikatat ISO 9001 dhe ISO 13485 si dhe certifikatën CE te produkteve, janë trajtuar me sqarimet shtesë te datës 26.05.2023, andaj referoju sqarimeve te dhëna.

- Sa i përket pretendimit rreth Specifikimeve teknike, janë trajtuar me sqarimet shtesë te datës 26.05.2023, andaj referojuni sqarimeve te dhëna.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. Pro Medical SHPK
2. Operatoreve ekonomik te interesuar


Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit